

**AKT NORMATIV**  
**Nr. 29, datë 13.9.2021**

**PËR MIRATIMIN E TEKSTIT TË DISA NDRYSHIMEVE NË MARRËVESHJEN  
PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN NGA DHE NDËRMJET *PFIZER EXPORT B.V.* DHE  
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË,  
MINISTRIT TË SHETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETT  
PUBLIK, MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 18.1.2021**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

**Miratimi i tekstit të disa ndryshimeve**

Miratimin e tekstit të disa ndryshimeve në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 2

**Detyrimet e organeve shtetërore**

1. Ndryshimet në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.*, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, bashkëlidhur këtij akti normativ, për shkak të sekretit tregtar, nuk do të publikohen në asnjë *website* të institucioneve apo në Fletoren Zyrtare.

2. Të gjitha institucionet e përfshira në dhënien e mendimit, të miratimit apo që janë pjesë e procesit kanë detyrimin të mos bëjnë publike ndryshimet në marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ apo pjesë të saj.

3. Detyrimet e organeve shtetërore dhe përjashtimet nga detyrimet për furnizimin e vaksinës anticovid, të përcaktuara në aktin normativ nr. 1, datë 10.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, janë të njëjta edhe për tekstin e marrëveshjes, bashkëlidhur këtij akti normativ.

Neni 3

**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**